




REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDER KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. 2-0/DPK	Nr Prot. Br Prot. 01-466/15
Nr i faq. Broj stranica 02	Data Datum 23.02.2015
PRISHTINE	



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI – CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 20.02.2015, mori:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK–03-4700/14, për Bekim Berisha, Anëtar i Bordit Menaxhuës ne Fondin e Sigurimit të Depozitave ne Kosovë, për shkak se zyrtari i lartë publik ka shmangur gjendjen e mundshme të konfliktit të interesit në të cilën ndodhej.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Në rastin e shqyrtuar për konflikt të interesit me numër protokolli AKK–03-4700/14, që për trajtim ka pasur zyrtarin z. Bekim Berisha, Anëtar i Bordit Menaxhuës ne Fondin e Sigurimit të Depozitave ne Kosovë.

Gjatë zhvillimit të procedurës dhe analizimit të gjendjes është konstatuar se zyrtari z. Bekim Berisha, Anëtar i Bordit Menaxhuës ne Fondin e Sigurimit të Depozitave ne Kosovë, gjatë kohës së ushtrimit të funksionit publik si zyrtar i lartë, është i angazhuar ne veprimtari private si pronar dhe person i autorizuar, ne një biznes privat e që sipas Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik Nr. 04/L- 051, kjo situatë paraqet konflikt të mundshëm të interesit, dhe mos pajtueshmëri në ushtrimin e funksionit publik, andaj Agjencia kundër Korrupsionit me datën 15.12.2014, e ka njoftuar zyrtarin e lartë me shkresën e parë se ka filluar procedura e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të Konfliktit të Interesit dhe se ka të drejtë në afatin prej 15 ditësh të njoftohet me faktet që posedon Agjencia.

Pas kësaj shkrese z. Bekim Berisha, ka ardhur ne takim dhe eshte njoftuar nga zyrtarët e AKK-së, dhe i janë prezantuar faktet qe disponon Agjencia lidhur me dyshimin për konflikt te mundshëm te interesit.

z. Berisha, gjatë takimit është pajtuar me gjendjen, por na ka njoftuar se biznesi ne fjale nuk zhvillon aktivitet dhe është zotuar se brenda afatit ligjore do ta bej ndryshimin e kërkuar nga AKK, dhe do te largohet nga personi i autorizuar ne këtë biznes .

Me datën 09.02.2015, kemi marr njoftimin zyrtar nga ARBK, ku dëshmohet se janë bërë ndryshimet e kërkuar dhe dëshmohet se z. Bekim Berisha, Anëtar i Bordit Menaxhuës ne Fondin e Sigurimit të Depozitave ne Kosovë, nuk figuron si person i autorizuar ne biznesin “Bekim Berisha Sh.P.K” me numër biznesi 70315721.

Vlerësojmë se pas ndryshimeve te bëra ne biznes, dhe pas rrethanave te krijuara konsiderojmë se është shmangur gjendjen e mundshme e konfliktit të interesit për zyrtarin z. Bekim Berisha, Anëtar i Bordit Menaxhuës ne Fondin e Sigurimit të Depozitave në Kosovë, andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja,

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./znj. (zyrtari kontaktues)

Plasan Breteni
Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit

